

FLETË INFORMUESE

Për vaksinimin kundër COVID-19 (**Corona Virus Disease 2019**)

– vaksinë me vektor – (Vaxzevria®, e njohur më parë si vakcina AstraZeneca COVID-19 nga AstraZeneca dhe vakcina Janssen® COVID-19 nga Johnson & Johnson)

Që prej datës 1 prill 2021 (kjo fletë informuese përditësohet vazhdimisht)

Emri i personit që do të vaksinohet (ju lutemi me shkronja shtypi):

Datëlindja:

Çfarë është COVID-19?

Koronaviruset njihen prej dekadash. Që nga ndërrimi i viteve 2019/2020, në mbarë botën po qarkullon një lloj i ri i koronavirusit, SARS-Coronavirus-2 (SARS-CoV-2), i cili është shkaktar i sëmundjes COVID-19 (Corona Virus Disease 2019).

Ndër simptomat e shpeshta të COVID-19 përfshihen kollat e thatë, temperatura, vështirësia në frymëmarrje, si dhe një humbje e përkohshme e shqisës së nuhatjes dhe të shijuarit. Gjithashtu është raportuar edhe për një ndjesi të përgjithshme sëmundjeje me dhimbje koke dhe gjymtyrësh, dhimbje fyti dhe rrufë. Në raste më të rralla, pacientët raportojnë ankesa gastrointestinale, konjunktivit dhe ënjtje të nyjave limfatike. Dëme në sistemin nervor ose kardiovaskular, si dhe ekziston mundësia për procese afatgjata të sëmundjes. Edhe pse kalimi i lehtë i sëmundjes është diçka e zakonshme dhe shumica e personave të sëmurur shërohen plotësisht, mund të ndodhin raste të rënda të sëmundjes me pneumoni, dhe kjo mund të çojë deri në vdekje.

Përveç shmangies së infeksionit duke respektuar rregullat AHA + A + L (mbaj distancën, zbato higjienën, mbaj maskë të përditshme, shkarko aplikacionin Corona-Warn, ajros rregullisht dhomat), vaksinimi ofron mbrojtjen më të mirë të mundshme kundër sëmundjeve.

Për cilën vaksinë bëhet fjalë?

Shumë vakcina janë aprovuar kundër COVID-19, që janë po kaq të efektshme për mbrojtje individuale kundër COVID-19 dhe si përgjigje ndaj pandemisë. Vaksinat me vektor të COVID-19 që diskutohen këtu (Vaxzevria® nga AstraZeneca, e njohur më parë si vakcina AstraZeneca® COVID-19) janë vakcina të projektuara në mënyrë gjenetike, prodhimi i të cilave bazohet në një teknologji të avancuar. Vaksinat me vektor kundër sëmundjeve të tjera janë të miratuara tashmë.

Vaksinat përbëhen nga të ashtuquajturat viruse vektori. Virusi vektor në fjalë është një virus i studiuar mirë, i cili nuk mund të shumëfishohet. Këto nuk janë vakcina të gjalla. Virusi vektor përmban dhe transporton informacionin gjenetik për një proteinë të vetme të koronavirusit, të ashtuquajturën proteinë spike. Vaksinat e COVID-19 me vektor nuk përmbajnë viruse që mund të shumëfishohen, që do të thotë se personat e vaksinuar nuk mund t'ua transmetojnë virusin personave të tjerë.

Informacioni i transmetuar nga virusi me vektor nuk integrohet në gjenomin e njeriut pas vaksinimit por "lexohet" pas hyrjes (kryesisht në qelizat e muskujve në vendin e vaksinimit dhe në disa qeliza të mbrojtëse) ku qeliza të tilla prodhojnë vetë proteinën Spike. Në vetvete, proteinat Spike nuk mund

të shkaktojnë infeksion me SARS-CoV-2. Proteinat Spike, të gjeneruara në këtë mënyrë nga vetë trupi i personit të vaksinuar si proteina të huaja nga sistemi imunitar; si rezultat antitrupa dhe qeliza imune prodhohen kundër proteinës Spike të virusit. Kështu krijohet një përgjigje mbrojtëse imune.

Virusi me vektor nuk mund të riprodhohet në trupin e njeriut dhe shpërbëhet pas një kohe të shkurtër. Pas kësaj, nuk prodhohet asnjë proteinë shtesë e virusit (proteinën spike).

Si bëhet vakcina?

Vaksina injektohet në muskulin e sipërm të krahut. Vaxzevria® nga AstraZeneca duhet të bëhet dy herë. Për mbrojtje të mjaftueshme të vaksinimit Komiteti i Përhershëm i Vaksinimit pranë Institutit "Robert Koch" (STIKO) rekomandon një interval prej 9 deri në 12 javë ndërmjet vaksinimeve të para dhe të dyta. Për momentin, vaksinimi i dytë duhet të bëhet me të njëjtën vaksinë nga i njëjti prodhues që është përdorur për vaksinimin e parë; bëjnë përjashtim personat nën 60 vjeç, për të cilët Vaxzevria® nga AstraZeneca është përdorur për vaksinimin e parë. Për këta persona, aktualisht STIKO rekomandon që vaksinimi i dytë të bëhet 12 javë pas vaksinimit të parë me një vaksinë mRNA (vaksina për COVID-19 Comirnaty® nga BioNTech/Pfizer ose vakcina për COVID-19 Moderna® nga Moderna).

Vaksina për COVID-19 Janssen® nga Johnson & Johnson duhet të bëhet vetëm një herë.

Sa i efektshëm është vaksinimi?

Duke u bazuar në njohuritë e deritanishme, të dyja vaksinat me vektor kundër COVID-19 ofrojnë efikasitet të mirë: Vaxzevria® e AstraZeneca pati deri në 80% efikasitet në të gjitha grupmoshat kur u ndoq intervali 12-javor midis vaksinimeve, siç u rekomandua nga STIKO, dhe vakcina kundër COVID-19 Janssen® e Johnson & Johnson pati rreth 65% efikasitet. Kjo do të thotë se mundësia për t'u infektuar me COVID-19 ishte deri në 80% (Vaxzevria® nga AstraZeneca) ose rreth 65% (vaksina Janssen® kundër COVID-19 nga Johnson & Johnson) mes personave të vaksinuar për COVID-19 më e ulët se te personat që nuk ishin vaksinuar. Efikasiteti për sa i përket parandalimit të sëmundjes së rëndë me COVID-19 (p.sh. shtrimi në spital) ishte edhe më i lartë: rreth 95% me vaksinën Vaxzevria® për COVID-19 nga AstraZeneca dhe rreth 100% me vaksinën Janssen® kundër COVID-19 nga Johnson & Johnson. Prandaj, nëse një person i vaksinuar me këtë vaksinë kundër COVID-19 bie në kontakt me patogjenin, ekziston një probabilitet i lartë që personi të mos sëmuret. Ende nuk dihet se për sa kohë zgjat mbrojtja nga vakcina.

Edhe nëse e bëni vaksinën, është e nevojshme që të vazhdoni të zbatoni rregullat AHA + A + L dhe të mbronni veten dhe njerëzit rreth jush. Arsyeja është se mbrojtja nuk fillon menjëherë pas vaksinimit, dhe kjo mbrojtje nuk është e njëjtë te të gjithë personat që kanë bërë vaksinën. Përveç kësaj, ende nuk mund të thuhet me siguri nëse personat që kanë bërë vaksinën mund të vazhdojnë ta përhapin virusin (SARS-CoV-2).

Kush përfiton veçanërisht nga një vaksinë kundër COVID-19?

Janë aprovuar disa vakcina kundër COVID-19, të cilat janë njëloj të përshtatshme për mbrojtje ndaj COVID-19 dhe për të luftuar pandeminë. Për sa kohë që një sasi e mjaftueshme vaksinash nuk është e disponueshme për t'i furnizuar të gjithë, është e rëndësishme të vaksinohen personat që janë më të rrezikuar të sëmurën rëndë ose të vdesin nga COVID-19, ata që kanë një rrezik veçanërisht të lartë të infektimit me SARS-CoV-2 për shkak të punës së tyre ose që kanë kontakte me njerëz që janë veçanërisht në rrezik nga COVID-19 si pasojë e profesionit të tyre, duhet të vaksinohet në mënyrë preferenciale.

Kush nuk duhet vaksinuar?

Meqenëse vaksinat me vektor kundër COVID-19 nuk janë aprovuar për fëmijët dhe adoleshentët deri në moshën 17 vjeç, ata nuk duhet të vaksinohen me vaksinat me vektor kundër COVID-19.

STIKO rekomandon që vaksinën Vaxzevria® kundër COVID-19 nga AstraZeneca ta bëjnë vetëm personat me moshë 60 vjeç e sipër. Për të rriturit nën këtë limit moshe, aktualisht STIKO nuk rekomandon që të bëhet vaksinimi me këtë vaksinë, pasi në disa raste të rralla kanë ndodhur sëmundje të rënda, kryesisht te njerëzit nën moshën 60 vjeç. Ndër to përfshiheshin mpiksje gjaku (trombozë), së bashku me ulje të numrit të pllakëzave të gjakut (trombocitopeni), dhe ndonjëherë ishin të shoqëruara me rrjedhje gjaku. Disa prej këtyre personave kanë vdekur.

Për personat me moshë 60 vjeç e sipër, rreziku për t'u sëmurur rëndë me COVID-19 apo rreziku i vdekjes nga COVID-19 është mjaft më i lartë se te personat me moshë më të re. Përveç kësaj, komplikacionet që tregohen më sipër, kanë ndodhur kryesisht te personat me moshë më të re se 60 vjeç. Prandaj, vaksinimi me Vaxzevria® nga AstraZeneca rekomandohet për personat me moshë 60 vjeç e sipër. Është vërtetuar se vakcina ka efikasitet të mirë edhe në këtë grupmoshë.

Sipas rekomandimit të STIKO, vazhdon të jetë i mundur vaksinimi me Vaxzevria® nga AstraZeneca për njerëzit nën moshën 60 vjeç, nëse këta persona e marrin vendimin së bashku me mjekun.

Vaksinimi i dytë pas vaksinimit të parë me Vaxzevria® nga AstraZeneca: për personat e moshës 60 vjeç e sipër, të cilët e kanë bërë vaksinën e parë me Vaxzevria® nga AstraZeneca, rekomandohet që ta bëjnë edhe vaksinën e dytë me Vaxzevria® nga AstraZeneca.

Për personat nën moshën 60 vjeç që janë vaksinuar tashmë me Vaxzevria® nga AstraZeneca, aktualisht STIKO rekomandon që vakcina e dytë të bëhet 12 javë pas vaksinës së parë me një vaksinë mRNA (vakcina Comirnaty® kundër COVID-19 nga BioNTech/Pfizer ose vakcina Moderna® kundër COVID-19 nga Moderna.

Kushdo që vuan nga një sëmundje akute me temperaturë mbi 38,5°C duhet të vaksinohet vetëm shërimit. Sidoqoftë, një ftohje ose një temperaturë paksa e ngritur (nën 38,5°C) nuk është arsye për ta shtyrë vaksinimin. Nëse keni ndjeshmëri të lartë ndaj një përbërësi vaksine, nuk duhet të vaksinoheni: ju lutemi informoni mjekun/mjeken e vaksinimit para vaksinimit nëse keni alergji. Çdo person që ka pasur reaksion të menjëhershëm alergjik (anafilaksis) pas vaksinës së parë, nuk duhet ta bëjë vaksinën e dytë.

Personat më imunitet që kanë rezultuar të infektuar me koronavirusin e ri është konfirmuar që mund të vaksinohen jo më herët se 6 muaj pas rikuperimit ose pas diagnozës dhe duhet të marrin vetëm një dozë të vaksinës. Aktualisht, nuk mund të thuhet nëse një dozë e dytë pasuese është e nevojshme për këta persona. Personat, të cilët kanë rezultuar të infektuar me koronavirusin e ri pas vaksinimit të parë, është provuar që mund të marrin dozën e dytë jo më herët se 6 muaj pas infektimit, sipas rekomandimeve të STIKO-s. Nuk ekzistojnë prova se vaksinimi përbën rrezik nëse dikush ka pasur infeksion në të kaluarën. Prandaj, nga ana mjekësore nuk është e nevojshme që kjo të përjashtohet para vaksinimit.

Nuk ka ende eksperiencë të mjaftueshme në lidhje me përdorimin e vaksinave me vektor të COVID-gjatë shtatzënisë dhe të ushqyerit me gji. Aktualisht STIKO nuk rekomandon vaksinimin e përgjithshëm gjatë shtatzënisë – pavarësisht llojit të vaksinës së COVID-19. Në raste të veçanta, grave shtatzëna me probleme shëndetësore ekzistuese të cilat janë në rrezik të lartë për sëmundje të rëndë të COVID-19 mund t'u ofrohet vaksinimi pasi të bëhet një analizim i rreziqeve/dobive dhe një konsultim i detajuar. STIKO mendon se është thuajse e pamundur që vaksinimi i nënës gjatë shtatzënisë të përbëjë rrezik për foshnjën.

Para vaksinimit tuaj, ju lutemi informoni mjekun tuaj nëse keni një çrregullim të koagulimit ose jeni duke marrë ilaçe antikoagulante. Ju mund të vaksinoheni me masa të thjeshta paraprake. Nuk ka asgjë që mund të parandalojë vaksinimin tek personat me imunitet të dobët. Sidoqoftë, vaksinimi mund të mos jetë aq i efektshëm tek persona të tillë.

Ju lutemi, para se të bëni vaksinën, t'i tregoni mjekut nëse keni alergji apo nëse keni pasur reaksion alergjik në të kaluarën pasi keni bërë ndonjë vaksinë. Mjeku do të sqarojë me ju nëse ka ndonjë arsye që të mos e bëni vaksinën.

Si duhet të sillem para dhe pas vaksinimit?

Nëse ju ka rënë të fikët pas një vaksinimi të mëparshëm ose një injeksioni tjetër, ose nëse jeni të prirur për alergji të menjëhershme, ju lutemi informoni mjekun/en e vaksinimit në përputhje me rrethanat. Pastaj ajo/ai mund t'ju vëzhgojë më gjatë pas vaksinimit.

Duhet të ketë një distancë kohore të paktën 14 ditësh nga vaksinat e tjera.

Nuk është e nevojshëm të pushoni pasi të keni bërë vaksinën. Në rastin e dhimbjeve ose etheve pas vaksinimit (shih "Cilat reaksione të vaksinimit mund të shfaqen pas vaksinimit?"), mund të merren ilaçe për qetësimin e dhimbjeve/uljen e temperaturës -. Mjeku/ja juaj i/e familjes mund t'ju këshillojë për këtë.

Kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore nëse pas vaksinimit keni vështirësi në frymëmarrje, dhimbje gjoksi, ënjtje të këmbëve ose dhimbje të vazhdueshme barku.

Duhet të vizitoheni menjëherë te mjeku nëse pas disa ditësh pas vaksinimit keni dhimbje koke të rënda ose të vazhdueshme ose turbullim të shikimit, ose nëse ju shfaqen mavijosje ose pika të kuqe në lëkurë jashtë vendit të injektimit pas disa ditësh.

Cilat reaksione të vaksinimit mund të shfaqen pas vaksinimit?

Pas vaksinimit me vaksinën me vektor të COVID-19, reaksionet lokale dhe të përgjithshme afatshkurta dhe të përkohshme mund të shfaqen si një shprehje e konfliktit të trupit me vaksinën. Këto reaksione mund të shfaqen në formën e etheve, të dridhurave dhe simptomave të tjera të ngjashme me gripin. Ato zakonisht largohen brenda disa ditëve pas vaksinimit. Për të lehtësuar simptomat e mundshme, një ilaç analgjezik/antipiretik mund të merret në dozën e rekomanduar.

Vaxzevria® nga AstraZeneca®: Reaksione më të shpeshta të vaksinimit të raportuara gjatë studimeve të miratimit ishin ndjeshmëria në vendin e injeksionit (më shumë se 60%), dhimbje në vendin e injeksionit, dhimbje koke dhe lodhje (më shumë se 50%), dhimbje të muskujve dhe parehati (më shumë se 40%), temperaturë e lartë dhe të dridhura (më shumë se 30%), dhimbje të kyçeve dhe përzierje (më shumë se 20%). Shpesh (ndërmjet 1% dhe 10%) janë raportuar të vjella, diarre, skuqje dhe ënjtje në vendin e injeksionit, të shoqëruara me ethe. Herë pas here janë raportuar (nga 0.1% deri në 1%) ënjtje të nyjave limfatike, ulje e oreksit, marrje mendsh, përgjumje, djersitje e tepërt, kruajtje dhe skuqje e përgjithshme.

Vaksina Janssen® kundër COVID-19 nga Johnson & Johnson: Disa nga reaksionet ndaj vaksinës, të cilat janë raportuar më shpesh në studimet e aprovimit, kanë qenë dhimbje në vendin e injektimit (më shumë se 40%), dhimbje koke, këputje dhe dhimbje muskulore (më shumë se 30%), dhe përzierje (më shumë se 10%). Më shpesh (midis 1% dhe 10%) janë raportuar temperaturë, kollë,

dhimbje kyçesh, skuqje dhe ënjtje në vendin e injektimit, si edhe të dridhura. Me raste (midis 0,1% dhe 1%), të dridhura, tështimë, dhimbje në gojë dhe në fyt, skuqje e përgjithshme e lëkurës, shtim të djersitjes, dobësi muskulore, dhimbje në krahë ose në këmbë, dhimbje shpine, ndjesi e përgjithshme dobësie dhe gjendje sëmurë.

Shumica e këtyre reaksioneve janë paksa më të rralla te personat e moshuar, sesa tek të rinjtë. Reaksionet e vaksinës janë zakonisht të lehta ose mesatare dhe me Vaxzevria® nga AstraZeneca ndodhin disi më shpesh pas vaksinimit të dytë, sesa pas vaksinimit të parë.

A janë të mundura ndërlikimet e vaksinimit?

Komplikacionet për shkak të vaksinës janë efekte të vaksinës që e tejkalojnë shkallën normale të një reaksioni nga vakcina, të cilat ndikojnë ndjeshëm në gjendjen shëndetësore të personit të vaksinuar.

Vaxzevria nga AstraZeneca: Që nga nxjerrja e vaksinës, në raste shumë të rralla janë vërejtur mpiksje të gjakut (trombozë), të shoqëruara me ulje të numrit të pllakëzave të gjakut (trombocitopeni), dhe ndonjëherë të shoqëruara me rrjedhje gjaku pas vaksinimit me Vaxzevria® nga AstraZeneca. Disa nga këto raste kanë qenë të rënda, ku përfshiheshin mpiksje të gjakut në vende të pazakonta (p.sh. trombozat e sinusit venoz cerebral ose në kavitetin abdominal, si tromboza e venës mesenterike), së bashku me rritje të aktivitetit të mpiksjes së gjakut, e madje rrjedhje të gjakut në trup. Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur katër deri në 16 ditë pas vaksinimit, dhe kryesisht te personat nën moshën 60 vjeç. Disa prej rasteve që përmenden kanë rezultuar fatale ose me dëmtime të pashërueshme.

Vaksina Janssen® kundër COVID-19 nga Johnson & Johnson: Në raste të rralla (0,01% deri në 0,1%) kanë ndodhur reaksione hiperndjeshmërie dhe urtikarie.

Që nga prezantimi i vaksinës, reaksione të menjëhershme alergjike (reaksione anafilaktike) janë raportuar në raste shumë të rralla. Ato ndodhën menjëherë pas vaksinimit dhe trajtimi mjekësor ishte i nevojshëm. Njëllëj si me të gjitha vaksinat, në raste shumë të rralla mund të ndodhë një reaksion alergjik i menjëhershëm deri në goditje shoku ose probleme të tjera nuk mund të përjashtohen kategorikisht edhe komplikacionet e tjera që nuk janë njohur më parë.

Nëse simptomat shfaqen pas një vaksinimi që i tejkalon shpejt reaksionet e përkohshme lokale dhe të përgjithshme, atëherë mjekja juaj e familjes/mjeku juaj i familjes natyrisht është në dispozicion për këshillim. Në rastin e ndikimeve të rënda, sidomos kur ka vështirësi në frymëmarrje, dhimbje kraharori, ënjtje në këmbë ose dhimbje e vazhdueshme barku, dhimbje të vazhdueshme barku, dhimbje të forta ose të vazhdueshme koke ose probleme me shikimin, ose nëse keni mavijosje ose rrjedhje gjaku në lëkurë jashtë vendit të injektimit disa ditë pas vaksinimit, ju lutem të kërkonti menjëherë ndihmë mjekësore.

Ekziston gjithashtu mundësia për t'i raportuar vetë efektet anësore:

<https://nebenwirkungen.bund.de>

Për plotësimin e kësaj flete informacioni, mjekja/mjeku juaj i vaksinimit do t'ju ofrojë një bisedë informuese.

Shënime:

Nënshkrimi i mjekut

Nënshkrimi i personit për vaksinim
ose nëse personi që do të vaksinohet nuk është
në gjendje të japë pëlqimin:
Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor)
(kujdestari, kujdestari ligjor)

Instituti "Paul Ehrlich" (PEI) është duke kryer një anketë rreth tolerancës së vaksinave për mbrojtjen nga koronavirusi i ri (SARS-CoV-2) me anë të aplikacionit të telefonit inteligjent SafeVac 2.0. Ju mund të regjistroheshi brenda 48 orëve pas vaksinimit. Pjesëmarrja në anketë është vullnetare.



Google Play App Store App Store Apple

Informacione të tjera për COVID-19 dhe për vaksinimin kundër COVID-19 gjeni në faqen

www.corona-schutzimpfung.de

www.infektionsschutz.de

www.rki.de/covid-19-impfen

www.pei.de/coronavirus

Botimi 1, Versioni 004 (nga 1 prill 2021)

Kjo fletë informuese është hartuar nga Deutsches Grünes Kreuz e.V. (Kryqi i Gjelbër Gjerman), Marburg në bashkëpunim me institutin Robert Koch, Berlin, dhe mbrohet me të drejtat e autorit. Ajo mund të shumëfishohet dhe të jepet më tej vetëm në kuadër të qëllimeve të saj për një përdorim jo komercial. Është e ndaluar të bëhet çfarëdolloj ndryshimi ose përpunimi.



in Kooperation mit

ROBERT KOCH INSTITUT



Anamneza për vaksinimin parandalues kundër COVID-19 (sëmundja e koronavirusit 2019) - me vaksinë me vektor (Vaxzevria[®], e njohur më parë si vaksina AstraZeneca kundër COVID-19 nga AstraZeneca dhe vaksina Janssen[®] kundër COVID-19 nga Johnson & Johnson)

1. A keni¹ aktualisht ndonjë sëmundje akute me temperaturë?

0 po 0 jo

2. A keni bërë tashmë¹ vaksinë për COVID-19?

0 po 0 jo,

Nëse po, kur dhe cilën vaksinë? Data: Vaksina:

(Ju lutemi, sillni kartën tuaj të vaksinimit ose prova tjera të vaksinimit në takimin tuaj të vaksinimit.)

3. Në rast se¹ keni marrë tashmë dozën e parë të vaksinës për COVID-19: A ju është shfaqur¹ reaksion alergjik më pas?

0 po 0 jo

4. A është vërtetuar në mënyrë të besueshme se jeni infektuar¹ me koronavirusin e ri (SARS-CoV-2) në të kaluarën? (Pas infektimit me SARS-CoV-2, vaksina rekomandohet jo më herët se 6 muaj pas shërimit ose diagnostikimit.)

0 po 0 jo

Nëse po, kur?

5. A keni¹ ndonjë sëmundje kronike ose a vuani¹ nga mungesa e imunitetit (p.sh. nga kimioterapia, terapia immunosupresive ose nga ilaçe të tjera)?

0 po 0 jo

Nëse po, cila

6. A vuani¹ nga ndonjë çrregullim i mpiksjes së gjakut ose jeni duke marrë ilaçe për hollimin e gjakut?

0 po 0 jo

7. A keni¹ alergji?

0 po 0 jo

Nëse po, cila

8. A keni¹ pasur ndonjë simptomë alergjike, temperaturë të lartë, të fikët ose reaksione të tjera të pazakonta pas një vaksinimi tjetër të mëparshëm?

0 po 0 jo

Nëse po, cila

9. Te gratë në moshë riprodhuese: A jeni aktualisht shtatzënë apo me gji¹?

0 po

0 jo

10. A jeni¹ vaksinuar brenda 14 ditëve të fundit? _____

0 po

0 jo

¹ Nëse është rasti, për këtë përgjigjet përfaqësuesi/përfaqësuesja ligjore.

Deklarata për dhënien e aprovimit për vaksinimin kundër COVID-19 (sëmundja e koronavirusit 2019) - me vaksinë me vektor - (Vaxzevria, e njohur më parë si vaksina AstraZeneca kundër COVID-19 dhe Janssen® nga Johnson & Johnson)

Emri i personit për vaksinim (mbiemri, emri):

Datëlindja:

Adresa:

Nëse personi që do të vaksinohet nuk është kompetent për të dhënë aprovimin, atëherë aprovimi ose refuzimi për vaksinimin duhet të jepet nga përfaqësuesi ligjor. Në rast të tillë, ju lutemi mos jepni emrin dhe detajet e kontaktit të përfaqësuesit ligjor:

Mbiemri, emri:

Nr. i telefonit:

E-mail:

Unë e kam marrë parasysh përmbajtjen e fletës informuese dhe kam pasur mundësinë të kem një diskutim të hollësishëm me mjeken e vaksinimit/mjekun e vaksinimit.

- Nuk kam pyetje të tjera.
- E miratoj vaksinimin e propozuar kundër COVID-19 me vaksinën me vektor.
- E refuzoj vaksinimin.
- Unë heq dorë shprehimisht nga konsulta mjekësore.

Shënime:

Vendi, data:

Nënshkrimi i personit për vaksinim
ose nëse personi që do të vaksinohet nuk
është në gjendje të japë pëlqimin:

Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor (kujdestari, kujdestari ligjor)

Nënshkrimi i mjekes/mjekut

Kjo fletë informuese është hartuar nga Deutsches Grünes Kreuz e.V. (Kryqi i Gjelbër Gjerman), Marburg në bashkëpunim me institutin Robert Koch, Berlin, dhe mbrohet me të drejtat e autorit. Ajo mund të shumëfishohet dhe të jepet më tej vetëm në kuadër të qëllimeve të saj për një përdorim jo komercial. Është e ndaluar të bëhet çfarëdo ndryshimi ose përpunimi.